



**NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.**  
**PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.**

Adr: Rr. Bill Clinton pn. Prishtinë-Kosovë  
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446  
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

### **K O N K U R S**

**Për zgjedhjen e dhjetë (10) Mjeshtëreve të Ndërtimit në Departamentin e Mirëmbajtjes, në Ndërmarrjen Publike Banesore –SH.A me seli në Prishtinë.**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Njihet me projektin dhe specifikimet teknike të punës që do të kryejë;
- Njihet me objektin e punës; Bën kontrollin paraprak të vendit të punës para fillimit të procesit;
- Bën kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt;
- Përzgjedh materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës;
- Respekton me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt; Respekton rregulloren e brendshme të përcaktuar më parë nga drejtuesi i punimeve në objekt;
- Bën piktimin e mureve të objektit ; Bën përgatitjen e sasisë së nevojshme të materialit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse;
- Të jetë i gatshëm të bëjë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt si përgatitja e llaçit, muratimi i mureve me materiale dhe dimensione të ndryshme, muratimi i mureve ndarëse, punimi i themeleve, punimi i armaturës, betonimi, kryerja e punimeve suvatuese, ndërtimi i kulmeve, punimi i dyshemeve me produkte të betonit, mbulimi i kulmeve, shtruarja dhe veshja me pllaka, kryerja e punimeve izoluese. Kryen edhe punë tjera që kërkohen nga Mbikëqyrësi;
- Për punët e kryera i raporton Mbikëqyrësit të Shërbimit.

#### **Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta:**

- Të ketë të kryer shkollën e mesme profesionale për mjeshtër të ndërtimit ose trajnim të certifikuar profesional
- Preferohet së paku dy (2) vite përvojë punë profesionale;

#### **Procedura e Konkurrimit**

Kandidati-ja për pozitën **Mjeshtër të Ndërtimit në Departamentin e Mirëmbajtjes** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- CV-në; Dëshminë e Kualifikimit Profesional; Dëshminë për Përvojën e Punës; Kopjen e Lejës së Njoftimit;

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, Bulevardi "Bill Clinton", p.nr., Prishtinë** ose përmes e-mailit zyrtarë: [burimet.njerezore@npbanesore.com](mailto:burimet.njerezore@npbanesore.com).

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

**Konkursi është i hapur nga data 22 Qershor 2017 – 06 Korrik 2017 ora 16:00.**